

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

Nga	Koment	Përgjigja e Grupit Punues të MFP-së GPMFP)
BE	1. Çështje të përgjithshme: Korniza e vlerësimit të rrezikut: Draft strategjisë dhe planit të veprimit u mungon një kornizë e vlerësimit të rrezikut, d.m.th., identifikimi i rreziqeve përkatëse dhe masave për zbutjen e rreziqeve.	Pranohet: vlerësimi i rrezikut është përfshirë në draftin e ri në Kapitullin 6.
	2. Kapitulli 2: Draft strategjia e reformës së MFP-së identifikon dobësitë dhe përparësitë e sistemit të MFP-së në bazë të diagnostifikimit përkatës (SIGMA, TADAT dhe PEFA). Vlerësimi mund të përfshijë informacione më të përditësuara dhe të pasqyroj më mirë gjendjen aktuale të reformave që janë në vazhdim e sipër (p.sh. Strategjia e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik) dhe të vlerësoj kapacitetin institucional të shërbimeve/ institucioneve përkatëse.	Pranohet, megjithatë në vend se të përgatiten tekste të ndara për vlerësimin e institucioneve të palëve të ndryshme të interesit, çështjet e kapaciteteve institucionale janë përfshirë në prioritetet për shkaqet rrënjësore dhe aktivitetet. Përveç kësaj, ajo do të adresohet në vlerësimin e rrezikut.
	3. Kapitulli 2: Strategjia ofron një vizion strategjik të reformës, duke nënvizuar prioritetet e reformës. Fushëveprimi dhe arsytimi i përzgjedhjes së prioriteteve është i definuar mirë në kapitullin 2.2, por nuk është dhënë asnjë arsytim i çështjeve të MFP-së që nuk mbulohen.	Nuk pranohet sepse do të nënkuptonte që dokumenti do të rritej për nga vëllimi dhe do të largonte fokusin në prioritetet. Përgjithësisht, theksohet se edhe për çështjet e MFP-së që nuk janë përfshirë në strategjinë e reformës së MFP-s, qeveria do të vazhdoj të përmirësohet në këto fusha, por nuk janë të përfshira në kornizën e strategjisë së MFP-së pasi që nuk konsiderohen si prioritet. Në rast se BE mendon se prioritetet nuk janë zgjedhur në mënyrë të drejtë, ne do të çmonim se cilat fusha duhet të përfshihen në reformën e MFP-së.
	4. Kapitulli 3: KBFP (PIFC) duhet të konsiderohet si një nga prioritetet. Përzgjedhja e auditimit të brendshëm si prioritet nënvlerëson rëndësinë e strategjisë, veçanërisht duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit të PEFA-s, strategjinë e miratuar të KBFP-së dhe qasjen e Komisionit ndaj kontrollit të brendshëm. Ne e kuptojmë se Strategjia e KBFP-së do të mbetet si një strategji individuale në kuadër të kornizës së MFP-së, megjithatë, KBF duhet të njihet si prioritet dhe nevojitet një referencë e fortë në strategjinë e PIC-së dhe elementet kryesore.	Nuk pranohet: Strategjia për reformën e MFP-së përfshin dy aspekte të PIFC-së si prioritet, përfshirë KBF dhe auditimin e brendshëm, të cilat përfshihen nën prioritetin 2 dhe prioritetin 8. Ne nuk pajtohemi që këto fusha të strategjisë së PIFC-së do të dëmtohen. Përkundrazi, rëndësia e këtyre fushave është theksuar duke i përfshirë ato si fusha prioritare në strategjinë e reformës së MFP-së.

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	5. Kapitulli 3: Shqyrtimi legjislativ po ashtu mund të jetë pjesë e reformës, për të rritur përfshirjen e kapaciteteve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) të Parlamentit për mbikëqyrjen e buxhetit.	Pranohet, por kjo është jashtë mandatit të grupit punues për MFP pasi që Parlamenti është i pavarur nga ekzekutivi. Grupi punues ka diskutuar me Parlamentin për të përfshirë mbikëqyrjen nga legjislativi si prioritet në strategji, por Parlamenti ka konsideruar që të forcojë aktivitetet e tij të mbështetura nga GIZ, ndarazi nga strategjia e reformës së MFP.
	6. Kapitulli 3: Sa i përket parashikimit të të hyrave, duhet të njihet si nevojë harmonizimi në mes të të dhënave statistikore të vendit dhe parashikimit të të hyrave makro-ekonomike	Pranohet: e adresuar në strategji.
	7. Kapitulli 4: Draft strategjia identifikon Grupin Koordinues për MFP-në si përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të reformës, megjithatë strategjia nuk e përmend në mënyrë eksplicite se ky grup do të përdoret për dialogun me palët e interesuara rreth politikave për zbatimin e reformës. Pasi që MF ka mbajtur tashmë një sërë takimesh konsultative gjatë hartimit të Strategjisë, përbërja e këtyre takimeve mund të përdoret për të përshkruar më në hollësi dialogun për politikën e MFP-së me funksionin e tij monitorues.	Pranohet: Në kapitullin 4 ne kemi përfshirë palët e interesit përgjegjëse që duhet përfshirë në grupin për monitorim dhe raportim për zbatimin e strategjisë për MFP. Ky grup po ashtu mund të veproj si grup për dialogun për politikën me BE-në. Pas miratimit të strategjisë për reformën e MFP-së, përfaqësuesit specifik do të emërohen.
	8. Kapitulli 5: Informacioni mbi kostimin duhet të paraqitet edhe sipas prioritetit.	Pranohet: korrigjuar në Kapitullin 5 të draftit të strategjisë.
SIGMA	1. Analiza e situatës: i. Kategorizimi i II dhe III nuk është logjik (mbledhja e kombinuar e të hyrave dhe ekzekutimi i buxhetit si të ndara nga kontrolli i shpenzimeve). Sugjerohet që kategoria II të përdoret për mbledhjen e të hyrave dhe kategoria III për ekzekutimin e buxhetit, menaxhimin e thesarit dhe kontrollet e shpenzimeve.	i. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri
	2. Prioriteti 1: i. çështja e parashikimit të të hyrave vetanake të komunave mund të përmendet këtu (shënim: kjo ka dal nga takimi konsultativ me shoqërinë civile)	i. Pranohet: është adresuar në strategji
	3. Prioriteti 2: i. Aktivitetet e përmendura nga Thesari nën 2.5 duhet të	i. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri të Strategjisë

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>integrohen në tekst si 2.6, 2.7 etj Pastaj, ato po ashtu duhet të përmendet edhe në Planin e Veprimit me zhvillimet kryesore (piketat). Vëreni se edhe aktiviteti 2.5 në Planin e Veprimit është hequr.</p> <p>ii. Në Planin e Veprimit: ju lutem kontrolloni vlerën bazë (referuese) të treguesit të objektivit. Matja standarde e SIGMA-s e përmend 5.5.</p>	<p>ii. Pranohet: 2.3 % është relevante ngase është vlerësimi me i ri dhe përfshin të dhënat e fundit nga PEFA 2015.</p>
	<p>4. Prioriteti 3:</p> <p>i. përshkrimi i aktiviteteve 3.3, 3. 4 dhe 3.5 në Strategji është shumë i detajuar dhe disa prej çështjeve nuk janë relevante për Strategjinë ose mund të integrohen si zhvillime kryesore (piketa) në Planin e Veprimit. Gjithashtu aktivitetet 3.7 - 3.12 janë shumë të detajuara për Strategjinë në nivel të Qeverisë dhe janë më të përshtatshme për planin e brendshëm të menaxhimit të Doganës.</p> <p>Në Planin e Veprimit:</p> <p>ii. Treguesi 2 i objektivit ndoshta mund të formulohet më mirë si % e numrit të përgjithshëm të taksapaguesve.</p> <p>iii. Gjithashtu, mungon objektivi për treguesin 2, ndërsa objektivi për treguesin 3 nuk është e qartë.</p> <p>iv. Nuk ka asnjë tregues për doganën. Ju lutem na tregoni nëse keni nevojë për ndihmë në propozimin e disa shembujve.</p>	<p>i. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri</p> <p>ii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri;</p> <p>iii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri;</p> <p>iv. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri.</p>
	<p>5. Prioriteti 4:</p> <p>i. Aktivitetet 4.3 dhe 4.4 duhet të integrohen në aktivitetin 4.2 që ka të bëjë me Udhëzimin e ri Administrativ. Kjo duhet të reflektohet në Planin e Veprimit.</p> <p>ii. Aktiviteti 4.8: testimi (pilot) mund të shtrihet jo vetëm për përgatitjen e KASH-it, por edhe për ekzekutimin e buxhetit për t'i dhënë ministrisë udhëheqëse në një sektor më shumë përgjegjësi mbi buxhetin e sektorit.</p>	<p>i. Pranohet: korrigjuar në strategji dhe Plan të veprimit;</p> <p>ii. Nuk pranohet: vendimet e mëtejshme në qasjen sektoriale në ekzekutimin e buxhetit do të merren vetëm në fazat më vonë. Shih po ashtu përgjigjen tonë për buxhetimin e bazuar në programe.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>Për Planin e Veprimit:</p> <p>iii. Një tregues që mat efektivitetin e UA-së për vlerësimin e ndikimit fiskal mungon dhe do t'ia shtonte vlerën.</p> <p>iv. Numërtimi në Planin e Veprimit duhet të jetë i harmonizuar me numërtimin në strategji.</p>	<p>iii. Pranohet: vlerësimi bëhet për të gjitha nismat buxhetore që shkojnë për aprovim në qeveri. Sidoqoftë është korigjuar në draftin e ri të PV</p> <p>iv. Pranohet: korigjuar në draftin e ri të PV</p>
	<p>6. Prioriteti 5:</p> <p>i. Aktiviteti 5.1 propozon të hartohet një udhëzim administrativ për të arsyetuar ri-ndarjet buxhetore (rialokimet) për të rritur besueshmërinë e buxhetit. Nuk është e qartë se pse nuk është konsideruar ndryshimi i LMFP-së pasi kjo do të tregonte një angazhim më të fortë për besueshmërinë e buxhetit.</p> <p>ii. Aktiviteti 5.2 Pika mbi buxhetimin bazuar në programe duket se më shumë lidhet me prioritetin 11 për transparencën se sa me besueshmërinë e buxhetit vjetor.</p> <p>iii. Nuk është e qartë se si buxhetimi bazuar në programe mund të futet në zbatim në situatën e tanishme me një numër kaq të madh të organizatave buxhetore. Ideja e futjes në zbatim të buxhetimin bazuar në programe duhet të përgatitet më mirë dhe do të kërkojë të bëhet një dallim në mes të organizatave buxhetore të nivelit të parë dhe atyre të nivelit të dytë.</p> <p>iv. Aktiviteti 5.3 Ideja e një buxheti miqësor (të përshtatshëm) për qytetarët gjithashtu mund të përfshihet nën prioritetin 11.</p>	<p>i. Nuk pranohet: një udhëzim administrativ konsiderohet zgjidhje e duhur.</p> <p>ii. Nuk pranohet: duke ditur lidhjen me Buxhetin, kjo mbahet në kuadër të Prioritetit 5.</p> <p>iii. Pranohet: në draftin e korigjuar, Plani i Veprimit përfshin përgatitjen e dokumentit të politikës strategjike për buxhetimin bazuar në programe duke u bazuar në përvojën më hershme para se të ndërmerren hapa të mëtejshëm.</p> <p>iv. Pranohet: korigjuar në draftin e ri.</p>
	<p>7. Prioriteti 6: Duke pasur parasysh implikimet e një klasifikimi më realist sa i përket shpenzimeve operative dhe atyre kapitale për tavanet buxhetore, mund të konsiderohet që së pari të bëhet një vlerësim i ndikimit në tavanet buxhetore dhe kjo të përfshihet si një aktivitet në Planin e Veprimit për vitin 2017.</p>	<p>Nuk pranohet - Kufijtë buxhetor përcaktohen me KASH si dhe me Qarkoret buxhetore për kategori ekonomike.</p>
	<p>8. Prioriteti 7:</p> <p>i. Përshkrimi i shkaqeve rrënjësore nuk është i kënaqshëm. Çështja nuk është se legjislacioni i prokurimit nuk është i cilësisë së mirë, por çështje është zbatimi i tij. Analiza e shkaqeve rrënjësore nuk</p>	<p>i. Pranohet: korigjuar në draftin e ri</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>e bën të qartë se cilat janë arsyet e zbatimit të pamjaftueshëm. Pastaj, mund të analizohet nëse aktivitetet e propozuara i adresojnë këto shkaqe në mënyrë të mjaftueshme.</p> <p>Në Planin e Veprimit:</p> <p>ii. Një tregues për objektivin duhet të lidhet me shpeshtësinë e parregullive të vërejtura nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;</p> <p>iii. Nuk është e qartë pse Aktiviteti 7.4 është e kufizuar në vitin 2016 dhe nuk është vazhduar edhe në vitin 2017 dhe 2018.</p>	<p>ii. Nuk pranohet, mendojmë se indikatorët e vendosur sigurojnë fuqizimin e zbatimit të ligjit</p> <p>iii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri dhe implikimet financiare janë përfshirë në Kapitullin 5 për kostimin</p>
	<p>9. Prioriteti 8: Një çështje kyçe në raportet diagnostike të PEFA-s, SIGMA-s dhe ZAP-së është niveli i ulët i veprimit pasues (follow up) sipas rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Kjo çështje nuk është përmendur në përshkrimin e problemit dhe në analizën e shkaqeve rrënjësore. Si pasojë, nuk është propozuar asnjë aktivitet për të adresuar këtë çështje. Në aspektin pozitiv, është përmendur si tregues për të matur objektivin.</p>	<p>Pranohet: është përfshirë në pjesën e përshkrimit të problemit dhe analizën e shkaqeve, ndërsa veprimet në planin e Veprimeve e adresojnë këtë problem (përgjegjësia menaxheriale). Shtohet edhe një veprim.</p>
	<p>10. Prioriteti 9: Në Planin e Veprimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gabim shkrimi në aktivitetin 9.2: duhet të jetë "të vlerësojë përputhshmërinë e ZAP-it me ISSAI duke kryer një vlerësim të KMF SAI; (Kornizës për Matjen e Performancës së Institucionit Suprem të Auditimit)</li> <li>- Një zhvillim kryesor në 'skemën e certifikimit' tani është i lidhur me auditimin e performancës, por kjo duket të jetë vendosur gabimisht;</li> <li>- Në aktivitetin 9.5, shumica e zhvillimeve kryesore (piketave) nuk janë të formuluar në mënyrë specifike dhe të matshme, p.sh. 'dëgjimet publike'.</li> </ul>	<p>i. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri;</p> <p>ii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri</p> <p>iii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri</p>
	<p>11. Prioriteti 11: Analiza e transparencës nuk është aq e elaboruar dhe fokusohet vetëm në një aspekt të transparencës. Duke përdorur raportet e PEFA-s dhe SIGMA-s, duhet të përgatitet një analizë më e thellë dhe, rrjedhimisht, do të mund të propozohen aktivitete shtesë.</p>	<p>Pranohet, drafti i korrigjuar po ashtu përfshin aktivitetet shtesë nga Thesari si dhe bartjen e aktivitetit 'buxheti i qytetarit'</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	12. Prioriteti 12: Treguesi për objektivin nuk përfshin një bazë referuese dhe një synim (target).	Pranohet, por nuk mund të jepet akoma ndonjë shifër. Vlera standarde (referuese) do të përcaktohet gjatë analizës së kostos/benefitit.
IMF	1. Si projekt dokument, Strategjia e re për Reformën e MFP-së është një mundësi për të vlerësuar dhe adresuar mangësitë në sistemin e MFP-së. Diskutimi i atyre mangësive është megjithatë i kufizuar në të gjeturat e raporteve të jashtme si PEFA, dhe përfshin shumë pak nga ajo që vetë qeveria i sheh si mangësitë kryesore të tij. Një analizë e tillë do të sigurojë motivin e kërkuar dhe pronësinë mbi reformat e propozuara.	Nuk pranohet: Analizat e jashtme të pasqyruara në raportet e PEFA, SIGMA, TADAT dhe ZAP-së konsiderohen objektive dhe Qeveria e Kosovës i pranon ato si mangësitë (të metat) tona kryesore. Qeveria e Kosovës është plotësisht e përkushtuar të adresoj këto çështje në përputhje me propozimet e përfshira në strategjinë e reformës së MFP-së.
	2. Disa nga çështjet kyçe që do të mund të përfshihen në një analizë të tillë janë: (a) shpenzimi i tepruar parazgjedhor i cili rregullisht vë një barrë të konsiderueshme në zhvillimet fiskale; (b) sfidat e zbatimit dhe mbikëqyrjes sa i përket rregullave fiskale; (c) dështimi për tu përqendruar në mënyrë efektive në buxhetin afatmesëm, në vend të atij vjetor; (d) vështirësitë në zbatimin e disiplinës fiskale, transparencës dhe rregullave të MFP-së; dhe (e) dështimi për të adresuar gjetjet e auditimit dhe, kur është e nevojshme, për të ndjekur penalisht. Adresimi i disa prej këtyre do të kërkojë forcimin dhe fuqizimin e kornizës ekzistuese ligjore, përfshirë përmirësimin e dispozitave për përgjegjësitë fiskale dhe para-zgjedhore; përmirësimin e standardeve të raportimit; dhe rritjen e aftësive të personelit për të parashikuar më mirë shpenzimet buxhetore - strategjia pasqyron disa nga këto veprime, por do të kërkohej një mbulueshmëri më e plotë, po do të sigurohej analiza e mësipërme.	Nuk pranohet: çështjet problematike të sugjeruara në koment në fakt janë adresuar në strategjinë për reformën e MFP-së, por në forma dhe terme të ndryshme: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pika (a) është adresuar në prioritetin 1 për parashikimin e të hyrave;</li> <li>- Pika (b) është analizuar më në detaje në kuadër të “Disiplinës Fiskale”</li> <li>- Pika (c) është objektivi i prioritetit 4;</li> <li>- Pika (d) është adresuar në prioritetin 2 (kontrolli i zotimeve), 5 (besueshmëria e buxhetit) dhe prioritetin 10 (transparenca);</li> <li>- Pika (e) është pasqyruar në prioritetet 8 dhe 9.</li> </ul>
	3. Dokumenti duhet t'i referohet që në fillim Marrëveshjes Stand-By me FMN-në duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të saj në nxitjen e disiplinës fiskale, si dhe raportet e Asistencave të fundit Teknike (AT) të FMN-së, si raporti i vlerësimit të menaxhimit të investimeve publike (PIMA) i FAD-së, dhe raporti i STA-s mbi SFQ ( <i>Dept i Statistikave të FMN-së për Statistikat Financiare të Qeverisë</i> ).	Pranohet, drafti i korrigjuar i referohet marrëveshjes stand-by me FMN-në si politikë udhëzuese thelbësore, por ato mund të japin më pak udhëzime për sistemet teknike të MFP-së. Përshkrimi i programit me FMN është vendosur në fillim të dokumentit. Drafti i korrigjuar po ashtu i referohet raporteve të AT të FMN-së për PIMA dhe SFQ (statistikat financiare të qeverisë).

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>4. Përderisa dokumenti ofron një sfond të dobishëm dhe arsyetimet për reformat dhe objektivat (ose shtyllat / prioritetet) e reformave janë në tërësi të qarta dhe specifike, aktivitetet shpesh janë shumë jo specifike duke e bërë kështu të vështirë të shihet se çfarë veprimesh specifike do të ndërmerren në mënyrë që ato të mund të kostohen dhe të vlerësohet niveli e përpjekjeve të nevojshme të stafit. Për më tepër, disa çështje të rëndësishme nuk janë përfshirë në strategjinë e reformës së MFP, përfshirë (ndër të tjera) rregullat fiskale, rreziqet fiskale, PPP-të, mbikëqyrjen e NSH-ve, borxhin dhe menaxhimin e parasë.</p>	<p>Nuk pranohet. Veprimet adresojnë prioritetet të cilat janë caktuar pas analizës së vlerësimeve relevante në fushën e MFP. Kostimi është bërë fillimisht me metodën e SIGMA (e aplikuar për SMFP në rajon) si dhe në bazë të UA 03/2015. Të gjitha aktivitetet janë të kostuara.</p>
	<p>5. Për secilin prej aktiviteteve sipas prioriteteve të ndryshme, do të ishte e dobishme të identifikoheshin inputet e kërkuara - ndryshimet rregullative dhe doracakët, rekrutimi i stafit të ri, sistemet e IT-së, trajnimi dhe asistenca teknike - dhe kohën e tyre gjatë periudhës 5 vjeçare të strategjisë. Kjo do të ofronte një bazë më të fuqishme për kostimin e strategjisë.</p>	<p>Nuk pranohet. Ndarja e detajuar në kontribute është përgatitur si pjesë e aktivitetit të kostimit, por nuk është pasqyruar në Strategji dhe Plan të Veprimit që është formuluar në një nivel më të lartë të abstraksionit.</p>
	<p>6. Po ashtu do të ishte e dobishme të krijohen parakushtet për secilin aktivitet dhe lidhjet ndërmjet aktiviteteve, për të krijuar një renditje efektiv të reformave.</p>	<p>Nuk pranohet. Në rast se disa aktivitete të caktuara konsiderohen parakusht, ato janë renditur (sipas radhës) në Planin e Veprimit.</p>
	<p>7. Përgjegjësitë e menaxhimit të shtyllave dhe prioriteteve të ndryshme, duke përfshirë bashkërendimin ku përfshihen shumë palë të interesuara, duhet të caktohen në mënyrë formale. Menaxherët e shtyllave duhet të takohen një herë në muaj për të diskutuar progresin teknik dhe problemet me Sekretarin e Përgjithshëm. Po ashtu, meqenëse suksesi i disa aktiviteteve varet nga zbatimi i tyre në ministritë e linjës, ato duhet të përfaqësohen në komisionet koordinuese.</p>	<p>Pranohet pjesërisht: korrigjuar në Kapitullin 4 të draftit të ri i cili cakton menaxher të prioriteteve. Operacionalizimi i mëtejshëm në komisionin koordinues për aktivitete do të bëhet pas miratimit të strategjisë.</p>
	<p>8. Në fund, monitorimi dhe raportimi për Strategjinë e Reformës së MFP-së duhet të përfshijë në mënyrë periodike edhe donatorët, për t'i mbajtur ata të informuar dhe që ata të jenë bashkë me ju.</p>	<p>Pranohet, por rregullimet e dialogut për politikat në MFP do të bëhen pas miratimit të strategjisë nga qeveria dhe pritet që të përfshijnë donatorët dhe shoqërinë civile.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>9. Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të të hyrave</p> <p>i. Aktivitetet shkojnë përtej vetëm parashikimit të të hyrave duke sugjeruar nevojën për një titull më të gjerë si "Parashikimi realist makroekonomik dhe fiskal";</p> <p>ii. Propozimi për t'i dhënë pavarësinë Njesisë Makro duhet të arsyetohet më qartë duke pasur parasysh se ky ka për qëllim të jetë një dokument i miratuar nga qeveria; dokumenti mund të ofroj një model për këto njësi makro "të pavarura", p.sh. IMAD e Sllovenisë, dhe aktiviteti i reformës duhet të hartohet më me kujdes për të pasqyruar gamën e hapave dhe afateve kohore të nevojshme për të arritur një status të tillë - juridik, administrativ, emërimi i drejtorit dhe stafit, mbikëqyrja, detyrat e caktuara dhe afatet kohore, si duhet qeveria të përdorë produktin e saj,...;</p> <p>iii. Në ndërkohë, kriza e personelit në Njesisë e tanishme Makro duhet të zgjidhet në qoftë se ajo duhet të ndërmerret ndonjë aktivitet për reformën në kuadër këtij prioriteti;</p> <p>iv. Aktivitetet duhet të jetë më specifike në mënyrë që ato të mund të vlerësohen dhe kostohen si duhet, për shembull:</p> <p>v. Pasi që diskutimi mbi mundësinë e krijimit të një Këshilli Fiskal në kuadër të aktiviteteve të propozuara në faqen 17 konstaton se një Këshill i tillë nuk është real në Kosovë, kjo duhet të hiqet nga aktivitetet e propozuara dhe të përfshihet në diskutimet e përgjithshme;</p> <p>vi. Sfondi i aktivitetit që propozon një kufi mbi "të hyrat e njëhershme" nuk e shpjegon në mënyrë adekuate se çka është kjo, që e bën të vështirë për të vlerësuar nëse veprimet e propozuara do të adresojnë këtë çështje;</p> <p>vii. Në fund, parashikimi i identifikuar në aktivitete ka të bëjë me variablat (ndryshoret) makroekonomike, dhe ndonëse këto kanë një ndikim në parashikimin e të hyrave, ka nevojë të shikohet edhe në parametra të tjerë të parashikimit të të hyrave – siç janë</p>	<p>i. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri, e adresuar në tërë dokumentin.</p> <p>ii. pranohet, por është çështje për tu vendosur nga niveli politik. Në Strategji është dhënë versioni nga Ekipi përgjegjës dhe nga Zëvendësministri</p> <p>iii. Nuk pranohet sepse tashmë është në renditjen (sipas radhës) në planin e veprimit për adresimin e numrit të stafit të njesisë;</p> <p>iv. Nuk pranohet, Plani i Veprimit përcakton aktivitete në nivel më të lartë. Më shumë detaje gjenden në dokumentet përgatitore që e mbështesin kostimin;</p> <p>v. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri;</p> <p>vi. Nuk pranohet, lidhja ndërmjet aktivitetit 1.4 he problemet/shkakut rrënjësor duket e drejtpërdrejtë;</p> <p>vii. Pranohet, por këto çështje janë pjesë e metodologjisë së parashikimit të adresuar në aktivitetin 1.1;</p>
--	---	--



## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>baza e të hyrave, normat efektive, përmbushja dhe evazionit fiskal, shpenzimet tatimore, çmimet e mallrave, ... si dhe tendencat historike dhe efektet e njëhershme - asnjë prej të cilave nuk paraqitet në aktivitetet e propozuara.</p>	
	<p>10. Prioriteti 2: Kontrollat efektive e zotimeve</p> <p>i. Arsyetimi i përgjithshëm për këtë prioritet është kontrolli i borxheve, megjithatë nuk ka asnjë veprim që në mënyrë specifike ka themeluar raportimin për borxhet, edhe pse në mënyrë indirekte ky mund të jetë arsye për futjen e propozuar në zbatim të kontabilitetit aktual të modifikuar. Krijimi i raportit për borxhet brenda vitit do të ndihmonte fokusimin në këtë çështje në mënyrë që veprimet të mund të merret para fundit të vitit. Për më tepër, do të ishte me rëndësi të bëheshin studime për të identifikuar shkaqet kryesore të borxheve, si dhe zhvillimi i një programi për pastrimin e borxheve – synimi për reduktimin e borxheve në 1% të shpenzimeve deri në vitin 2020 tregon se problemi nuk do të eliminohet deri atëherë.</p> <p>ii. Ndryshimet e propozuara rregullative (në LMFPP) adresojnë disa mangësi rreth përgjegjësisë dhe kualifikimeve në LMFPP, por nuk përfshijnë ngarkimin e interesit në çdo faturë e cila mbetet e papaguar pas 60 ditësh.</p> <p>iii. Kalimi i propozuar në kontabilitetin aktual të modifikuar nuk mbështetet nga asnjë analizë përkatëse për mangësitë e praktikave aktuale të kontabilitetit dhe raportimit. Kjo ka të ngjarë të jetë një aktivitet thelbësor i reformës që zgjat disa vite për të cilën duhet të zhvillohet një udhërrëfyes i detajuar bazuar në një analizë të mangësive të praktikave aktuale krahasuar me IPSAS (për shembull).</p> <p>iv. Ka pak fokusim në kontraktimin shumëvjeçar dhe kontrollat e tjera të zotimeve, të cilat shpesh mund të kontribuojnë në borxhe.</p>	<p>i. Pranohet: Është adresuar me aktivitete të reja në strategji dhe plan të veprimit.</p> <p>ii. Pranohet: Duket si sugjerim i mirë për tu adresuar nga Thesari</p> <p>iii. Nuk pranohet. Strategjia i referohet strategjisë së PIFC-së e cila ofron analizën e gjendjes së tanishme;</p> <p>iv. Pranohet: është e adresuar në KASH</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>v. Nuk ka fare fokusim në praktikat e nën-buxhetimit, si në investimet e kontraktuara ashtu edhe në mirëmbajtje - kjo çështje është ngritur në raportin e FAD-së për PIMA.</p>	<p>v. Nuk pranohet. Organizata Buxhetore duhet gjatë planifikimit të buxhetit të jap prioritet obligimeve kontraktuale të cilat i kanë të nënshkruara me operatorët ekonomik. Kjo çështje ju epet me instruksionet me Qarkoret e Buxhetit me rastin e dorëzimit të kërkesave buxhetore.</p>
	<p>vi. Raportimi kryesisht është raportim ex-post, megjithatë ekziston një nevojë e qartë për të publikuar zotimet e papaguara si pjesë e dokumentacionit të buxhetit.</p>	<p>vi. Nuk pranohet pasi që Departamenti i Buxhetit me Qarkoret Buxhetore i njofton OB-të në lidhje me përfshirjen e obligimeve kontraktuale të ju ipet prioritet gjatë planifikimit të buxhetit që të përfshihen në kufijtë buxhetorë.</p>
	<p>vii. Përfshirja e kontrolleve më të gjera financiare sugjeron se një pjesë e kësaj agjende është duke u nxitur nga motivi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), të cilat më mirë do të përshtateshin në Shtyllën III - Efikasiteti operacional.</p>	<p>vii. Nuk pranohet, kontrollet e dobëta të zotimeve dëmtojnë disiplinën fiskale andaj mbetet ku ka qenë.</p>
	<p>11. Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave</p> <p>i. Aktivitetet janë përgjithësisht në pajtueshmëri me rekomandimet e FMN-së që dalin nga misioni TADAT dhe misionet e tjera të FAD-së në administratën e të hyrave.</p> <p>ii. Megjithatë disa nga aktivitetet janë mjaft të detajuara dhe mund të grupohen - për shembull 4 aktivitetet e fundit doganore ndoshta mund të grupohen nën një aktivitet më të gjerë të "forcimit të përdorimit të IT-së dhe informacionit në operacionet doganore".</p>	<p>i. Nuk ka koment</p> <p>ii. Pranohet: është korrigjuar në draftin e ri</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>12. Prioriteti 4: Hartimi i KASH-it</p> <p>i. Zhvillimi i një metodologjie të vlerësimit të të hyrave, shpenzimeve dhe pozitës financiare për 3 vite pas vitit fiskal do të ndihmojë për të mbështetur cilësinë e parashikimeve të shpenzimeve për KASH, dhe të sigurojë bazën e nevojshme referuese kundrejt të cilës vlerësohen buxhetet vjetore dhe propozimet e politikave të reja. Nuk përmenden askund vlerësimet e të hyrave, shpenzimeve dhe pozitës financiare për 3 vite pas vitit fiskal (forward estimates).</p> <p>ii. Problemet e përputhjes në mes tekstit dhe tabelave: aktivitetet 4.2, 4.3 dhe 4.4 në faqen 23 janë shkruar në një aktivitet (4.2) në tabelën në fund të dokumentit; dhe aktiviteti 4.5 në faqen 23 mungon në tabelën në fund të dokumentit.</p> <p>iii. Kontrolli mbi rritjen e buxhetit të pagave (aktivitetit 4.5) është më i rëndësishëm për disiplinën fiskale - kjo do të ishte më mirë të futej nën një aktivitet për rregullat fiskale, nëse do të kishte të tillë. Megjithatë, siç është praktikë në shpenzimet kapitale, një kufizim i tillë potencialisht mund të çojë në përdorimin e gabuar të klasifikimeve buxhetore, pasi që organizatat buxhetore përpiqen të anashkalojnë rregullën – d.m.th, duhet të ketë një veprim paralel për adresimin e keqpërdorimit të klasifikimeve ekonomike.</p> <p>iv. Dallimet e konsiderueshme në mes të parashikimeve të përdorura në KASH-in e prillit, të cilat janë të bazuara në projeksionet makro të vjeshtës, dhe parashikimeve të përdorura në buxhetin vjetor, të cilat janë të bazuara në projeksionet më të fundit makro të shtatorit, do të mund të zvogëlohen me zhvillimin dhe përdorimin e parashikimeve makro të pranverës (unë besoj se kjo është ajo që është propozuar në Prioritetin 1).</p>	<p>i. Nuk pranohet, vlerësimet /parashikimi për 3 vite pas vitit fiskal tashmë është pjesë e KASH-it. Cilësia e parashikimit është adresuar në prioritetin 1.</p> <p>ii. Pranohet: korrigjuar në draftin e ri. Veprimi 4.5 në strategji nuk ka qenë në zbatim. Me aprovimin e LMFPP në Janar 2016 është pjesë e ligjit. Largohet nga Strategjia.</p> <p>iii. Nuk pranohet: Shih me lart. Çështja këtu është përputhshmëria me rregullat fiskale ekzistuese në KASH. Çështja e klasifikimit të gabuar është adresuar në prioritetin 6.</p> <p>iv. Pranohet. Kjo ka kuptim , do të ishte aktivitet i mirë mirëpo duhet të adresohet në vitet e ardhshme (pas 2020), pasi që kjo çështje është e rregulluar me LMFPP.</p>
--	---	--

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>Kjo lidhje në mes të prioriteteve do të mund të theksohej qartë në mënyrë që përpjekja për përmirësimin e harmonizimit të ndërmerret e ndërlidhur me publikimin e parashikimeve makro në pranverë. Mund të ketë nevojë për të rishikuar kalendarin vjetor të buxhetit, me shtyrjen e miratimit të KASH-it deri në korrik për shembull.</p>	
v.	Nuk ka asnjë aktivitet që ka për synim paraqitjen e KASH-it në Kuvend për miratim, një prej shkaqeve rrënjësore të identifikuara në fillim të faqes 23.	v. Nuk pranohet , Sugjerim i mire por është çështje politike, dhe po ashtu kjo është e rregulluar me LMFP.
vi.	Nuk është e qartë pse GP dhe Komisioni për Planifikim Strategjik janë subjekt i një aktiviteti të reformës - krijimi i tyre është caktuar me dekret dhe aktivitetet e propozuara thjesht sugjerojnë operacionalizimin e tyre, një hap themelor administrativ. Në vend të kësaj, këto organe do të mund të identifikoheshin si parakushte të nevojshme për zbatimin efektiv të Prioriteteve 4 dhe 6 të Strategjisë së Reformës së MFP.	vi. Nuk pranohet, duhet të operacionalizohet në vitet e ardhshme gjë që konsiderohet me rëndësi strategjike.
vii.	Derisa kërkesa për organizatat buxhetore që të paraqesin vlerësimin e rrezikut duket si një zhvillim i mirë, pa një shqyrtim të hollësishëm nga Departamenti i Buxhetit dhe pa përfshirjen e tyre eventuale në deklaratën e rrezikut buxhetor vlera e tyre do të jetë i kufizuar, që do të thotë se cilësia e tyre ka të ngjarë të përkeqësohet me kalimin e kohës. Pastaj, a është qëllimi për të mbajtur organizatat buxhetore përgjegjëse ex-ante për çdo rrezik që ato nuk e kanë definuar (ose e kanë definuar në mënyrë joadekuate)? Nëse është kështu, atëherë kjo do të duhet të ngrihet në një nivel më formal në LMFP.	vii. Nuk pranohet. Hapi i parë është që të bëhen vlerësimet e rrezikut, por çështjet e ngritura janë kuptuar mirë dhe do tu kushtohet vëmendje e duhur në operacionalizim.
viii.	Qasja e sektoriale e KASH-it vërtetë do të ndihmojë në grupimin e organizatave të shumta buxhetore nën ministrinë e tyre amë. Megjithatë, kjo mund të ketë nevojë të mbështetet duke përshkruar përgjegjësitë e tilla në LMFP. Për më tepër, ky zhvillim do të ofrojë mundësinë për të forcuar lidhjen në mes të sistemeve të planifikimit dhe buxhetimit, si pjesë e	viii. Pranohet: Komenti është kuptuar qartë. Në prioritetin 5 lidhur me buxhetimin bazuar në programe, parashihet të përgatitet një dokument (shënim) strategjik për sistemin e buxhetimit si hap i parë. Qasja sektoriale do të jetë pjesë e kësaj analize.

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	operacionalizimit të kornizës të Planifikimit Strategjik të përmendur në Aktivitetin 4.1.	
	<p>13. Prioriteti 5: Besueshmëria e buxhetit vjetor</p> <p>i. Lidhur me aktivitetin e propozuar për rialokimet buxhetore, duket të jetë një rast i mirë për të rishikuar nivelin prej 25% të përcaktuar në LMFPP për transferet brenda një organizate buxhetore pasi kjo është dukshëm më e lartë se sa dispozita tipike prej 5-10%. Ky nivel i lartë i fleksibilitetit në mënyrë të qartë mund të keqpërdoret, sidomos gjatë kohës së zgjedhjeve, ku mund të ridrejtohen nivele të konsiderueshme të shpenzimeve pa miratimin nga Parlamenti.</p> <p>ii. Reformat që lidhen me rialokimet buxhetore për këtë arsye duhet të jenë më thelbësore se sa propozimi aktual për hartimin e një rregulloreje sipas LMFPP-së. Përveç reduktimit të maksimumit të rialokimeve të lejueshme pa miratimin parlamentar, ai duhet gjithashtu të kufizojë rialokimet e buxhetit ndërmjet kategorive kryesore ekonomike, p.sh. nga ato kapitale në ato rrjedhëse, apo në paga.</p> <p>iii. Kontrollat e lidhura me ndryshimet në pagat publike dhe përfitimet sociale duhet të rishikohen dhe të forcohen. Në veçanti, këto ndryshime duhet të kufizohen në procesin e miratimit të buxhetit që shkon përmes parlamentit, duke hequr kështu mundësinë e ndikimit në ndryshime vetëm nëpërmjet vendimeve ekzekutive. Kjo do të kërkonte ndryshim të LMFPP-së.</p> <p>iv. Për më tepër, pasi që çështja e rialokimit dhe e kontrollit të pagave të cekura më lart ka të bëjë më shumë me kontrollin e ekzekutimit gjatë vitit, ajo ndoshta mund të bashkohet me kontrollin e zotimeve nën Prioritetin 5 të ri-definuar të quajtur "Kontrollet e ekzekutimit të buxhetit".</p> <p>v. Buxhetimi bazuar në program është iniciativa kryesore si e tillë dhe me siguri meriton të ketë Prioritetin e vet. Edhe pse do të jetë vetëm një pilot projekt në vitin 2017, përhapja e tij edhe në</p>	<p>i. Nuk pranohet. Strategjia merret me përmirësimin e sistemit të MFP. Për këtë kërkohet plotësim ndryshimi i LMFPP.</p> <p>ii. Nuk pranohet. Strategjia merret me përmirësimin e sistemit të MFP. Kjo është e rregulluar me LMFPP dhe me Ligjin vjetor të buxhetit.</p> <p>iii. Nuk pranohet. Strategjia merret me përmirësimin e sistemit të MFP.</p> <p>iv. Pranohet, prioriteti i quajtur "besueshmëria e buxhetit dhe kontrolli i ekzekutimit"</p> <p>v. Pranohet: në draftin e korrigjuar, Plani i Veprimit përfshin hartimin e dokumentit të planit strategjik.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>ministrinë e tjera ka të ngjarë të fillojë shumë para vitit 2020. Kjo do të prek shumë fusha, përfshirë: planifikimin afatmesëm, integrimin e buxheteve rrjedhëse dhe kapitale, klasifikimet, ekzekutimet e buxhetit dhe kontabilitetin, sistemet e IT-së, shqyrtimet e buxhetit, auditimin. Ai gjithashtu do të kërkojë përpjekje të madhe nga stafi i Departamentit të Buxhetit, duke përfshirë krijimin e njësisë së metodologjisë, trajnime të rëndësishme në të gjitha fushat, dhe një gatishmëri të drejtuesve të lartë, politikanëve dhe parlamentarëve për tu fokusuar në rezultate/të arritura e jo në inpute.</p>	
	<p>14. Prioriteti 6: Cilësia e informatave për investimet publike</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i. Ky seksion duhet të pasqyrojë në mënyrë më të plotë gjetjet dhe rekomandimet e raportit të fundit të FAD-së për PIMA.</li> <li>ii. Derisa trajnimi pjesërisht mund të adresojë cilësinë e ulët të të dhënave në sistemin e PIP-it, ajo duhet të plotësohet me një aftësi më të madhe të Departamentit të Buxhetit për adresimin e sfidave përmes zhvillimit të mjeteve analitike në sistemin e PIP-it - ky konkluzion i raportit të FAD-së për PIMA nuk pasqyrohet këtu.</li> <li>iii. Çështja e krijimit të një listë të vetme të projekteve prioritare (për dallim nga shumë lista...) të projekteve të vlerësuara të shqyrtuara nga MF, e po ashtu rekomandimi i PIMA-s nuk trajtohet këtu.</li> <li>iv. Po ashtu nuk ka referencë për kornizën e PPP-ve, një instrument në rritje i investimeve publike, apo për investimet publike në NSH, të cilat kanë investime të konsiderueshme publike.</li> <li>v. Prezantimi i informacioneve të plota për projekte, në radhë të parë kostove gjatë tërë jetëgjatësisë së projektit dhe afateve kohore, nuk përfshihet në dokumentacionin e buxhetit e as zhvillimi i monitorimit dhe raportimit brenda vitit.</li> </ol>	<p>i., ii., iii., iv. Dhe v. Është shqyrtuar raporti i PIMA-s dhe konkluzionet dhe rekomandimet e aplikueshme janë përfshirë në draftin e ri.</p> <p>Departamenti i buxhetit ka ndërhy në përshkrim të Strategjisë tek aktivitetit 6.1 (6.1-6.2) që është paraqit si aktivitet i ri.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>15. Prioriteti 7: Prokurimi Publik</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Këto aktivitete duken të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse.</li> <li>ii. Çdo zgjerim i listës së aktiviteteve të prokurimit të centralizuar duhet të bëhet në bazë të kritereve sistematike të cilat i japin prioritet mallrave dhe shërbimeve që janë ekonomikisht të rëndësishme.</li> <li>iii. Strategjia duhet të përkrah një shtytje më të fortë për të zgjeruar prokurimin e centralizuar dhe prokurimin elektronik në të gjitha qeveritë lokale dhe ndërmarrjet publike, shumë prej të cilave nuk janë ende formalisht nën ombrellën e tij.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>i.</li> <li>ii. Pranohet, e adresuar në aktivitetin 7.2</li> <li>iii. Nuk pranohet, pasi është e adresuar me aktivitetin 7.1. me Vendimin e Qeverisë nga 01 Prill 2016 AQP është e obliguar të zhvilloj aktivitetet e prokurimit përmes sistemit të e-prokurimit, OB qendrore nga 01 Shtator 2016 dhe OB tjera prej 01 Janar 2017.</li> </ul>
	<p>16. Prioriteti 8: Forcimi i auditimit të brendshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Këto aktivitete duken mjaftueshëm gjithëpërfshirëse.</li> <li>ii. Megjithatë, veprimi pasues sipas rekomandimeve të auditimit të brendshëm, si dhe gjetjeve të auditimit të jashtëm nga auditorët e brendshëm po ashtu duhet të adresohet plotësisht.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>i. -</li> <li>ii. Pranohet. Është adresuar në prioritetin 8 dhe te Plani i Veprimit me një veprim të ri.</li> </ul>
	<p>17. Prioriteti 9: Forcimi i auditimit të jashtëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Këto aktivitete duken shumë të arsyeshme dhe gjithëpërfshirëse nga pikëpamja e zhvillimit të ZAP-it.</li> <li>ii. Megjithatë ka shqetësime të mëdha për mungesën e veprimit lidhur me gjetjet e auditimit, përfshirë edhe ndjekjen penale në rastet e korrupsionit dhe mashtrimit. Numri i rasteve të vjetra [të pazgjidhura] gjyqësore dhe referimet lidhur me kontratat e investimeve publike po ashtu duhet të adresohen në mënyrë që auditimet ex-post të projekteve kapitale të mund të bëhen në mënyrë rutinore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>i. -</li> <li>ii. Pranohet, por çështja është ngritur në kuadër të prioritetit 9 dhe adresohet përmes bashkëpunimit më të mirë ndërmjet ZAP-së dhe Parlamentit. Të dy institucionet janë të pavarura nga ekzekutivi.</li> </ul>
	<p>18. Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të IT-së</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Në përgjithësi këto aktivitete duken të arsyeshme, edhe pse do të ishte mirë të zhvillohet një master plan i IT-së (nëse kjo nuk është bërë), dhe të ndërmerret një rishikim funksional të sistemeve aktuale për të identifikuar se ku janë mangësitë (përsëri nëse kjo nuk është bërë), para fillimit të investimeve të mëdha të parashikuara nën këtë prioritet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>i. Komenti pranohet: me mbështetje të USAID është i zhvilluar plani strategjik i TI.</li> </ul>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>19. Prioriteti 11: Transparenca e informacioneve të buxhetit</p> <p>i. Kjo duket se nuk është në përputhje me këtë shtyllë ndërsektoriale. Kjo normalisht do të ishte pjesë e një aktiviteti të kontabilitetit dhe raportimit, por kjo mungon në Strategjinë e Reformës së MFP-së.</p> <p>ii. Rekomandimet e AT-së së fundit të STA-së do të mund të adresohen në mënyrë të dobishme nën këtë prioritet, në veçanti rregullimet në planin kontabël, klasifikimin e institucioneve, mbulimin e raporteve, si dhe hartimin e serive kohore tremujore dhe vjetore të borxhit.</p>	<p>i. Nuk pranohet, kjo duket të jetë çështje e grupimit dhe kategorizimit e jo çështje substanciale. Siç u komentua më lartë, bazuar në diagnozën, kontabiliteti dhe raportimi nuk janë zgjedhur si prioritet i veçantë.</p> <p>ii. Pranohet. E adresuar në strategji.</p>
	<p>20. Prioriteti 12: Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme të MFP-së</p> <p>i. Këto aktivitete janë të arsyeshme - trajnimi është thelbësor për suksesin e reformave. Megjithatë, do të ishte mirë të shihet theksi në përdorimin e stafit për të ofruar trajnimin e MFP-së, dhe ndoshta zhvillimin e një programi për trajnimin e trajnerëve në bashkëpunim me iniciativat rajonale për ngritjen e kapaciteteve për MFP, siç është CEF. Gjithashtu tani janë në dispozicion vegla të rëndësishme mësimore on-line që mund të përdoren në kombinim me mësimdhënien ballë për ballë.</p>	<p>i. Pranohet, por nuk kërkohet ndryshimi i strategjisë. Sugjerimi do të përfshihet në analizën e propozuar të kost-benefitit.</p>
GIZ	<p>1. Llogaridhënia/ çështja: Raporti i realizimit [të buxhetit] Qeverisë Mbikëqyrja parlamentare e buxhetit bëhet <i>ex-post</i> duke shqyrtuar hollësisht se si janë përdorur fondet publike dhe <i>ex-ante</i> në diskutimin e propozim buxhetit. Për diskutime efektive buxhetore, Parlamentarët do të jetë në gjendje të marrin në konsideratë rezultatin e shqyrtimit <i>ex-post</i> të buxhetit.</p> <p>Raporti financiar vjetor i cili publikohet nga Qeveria paraqitet dy herë në seancë plenare, në prill dhe tetor. Fillimisht në prill Qeveria i paraqet Parlamentit Raportin Financiar vjetor të pa-audituar dhe KBF e shqyrton atë dhe më pastaj e dërgon në Kuvend për miratim. Për më tepër, në tetor të i njëjti raport paraqitet në seancë plenare nga KMFP së bashku me opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (raporti i auditimit). Mangësi në këtë çështje është se, fillimisht raporti financiar vjetor i pa-audituar</p>	<p>Nuk pranohet: Komenti është jashtë mandatit të grupit punues për MFP pasi që Parlamenti është i pavarur nga ekzekutivi.</p>



## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>mund të dërgohet në KBF për tu shqyrtuar dhe si burim informacioni, por si i tillë, ky raport i pa-audituar nuk duhet të miratohet në seancë plenare. Pra, ne mendojmë se ky raport duhet të dërgohet vetëm një herë në seancë plenare, pasi të jetë audituar nga ZAP dhe shqyrtuar nga KBF dhe KMFP. Prandaj rekomandohet që rekomandimet nga KMFP të paraqiten dhe votohen në seancën plenare para votimit të Kuvendit për buxhetin e vitit të ardhshëm.</p>	
	<p>2. Çështja: Mbikëqyrja parlamentare Në pikën 2.1.5 të strategjisë në paragrafin për Mbikëqyrje parlamentare thuhet: "Nuk ka përfshirje të planifikuar të komisioneve funksionale si ai për Zhvillim Ekonomik, Shëndetësi apo Arsim gjatë procesit të shqyrtimit të buxhetit vjetor" ne e kundërshtojmë fuqishëm që komisioni funksional të përfshihet në diskutimin e buxhetit. Arsyeja është se komisioni funksional gjithmonë do të vijë me kërkesa të paarsyeshme buxhetore të cilat mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e buxhetit. Gjithashtu, komisioni funksional nuk duhet të përqendrohet në mbikëqyrjen e çështjeve financiare, derisa janë dy komisione (KBF dhe KMFP) të që e kanë mandatin për të bërë këtë gjë. Propozimi për zgjidhje: Ne mendojmë se KBF është komisioni i vetëm i cili duhet të shikoj tërë situatën e përgjithshme të buxhetit nga perspektiva e qëndrueshmërisë buxhetore dhe fiskale. Lidhur me këtë GIZ ka mbështetur KBF-në për krijimin e sistemit të raportuesit, i cili do të bashkëpunojë me komisionet funksionale të parlamentit dhe do të marrë në konsideratë kërkesat e tyre në diskutimin e buxhetit duke ruajtur qëndrueshmërinë fiskale dhe buxhetore.</p>	<p>Pranohet: Strategjia nuk parasheh përfshirjen e Komisioneve tjera funksionale në shqyrtimin e Buxhetit, e adresuar.</p>
	<p>3. Çështja: Transparenca dhe informimi për buxhetin</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Duke synuar rritjen e transparencës ne propozojmë që në Prioritetin 11 të shtohet ky paragraf: Informacioni standard narrativ i sektorit duhet të përfshihet në KASH dhe në projekt-buxhetin vjetor. Ky aktivitet do të harmonizohet me kërkesat për raportim për mbështetjen e paraparë buxhetore sektoriale nga BE.</li> </ul>	<p>Pranohet: e adresuar në Prioritetin 11 (Buxheti miqësor). E adresuar edhe në strategji edhe në plan të veprimit.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>- Në gjithashtu të propozojmë të shtohet në pikën 11.2 Masë për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies mund të jetë mbështetja në dhënien e informacioneve të rëndësishme për planet e financave publike dhe veprimeve të qytetarëve (p.sh. Buxheti i Qytetarëve)</p>	
	<p>4. Çështja: Fuqizimi i auditimit të jashtëm Në Prioritetin 9.5 të strategjisë Forcimi i mbikëqyrjes është shpjeguar me një qasje të ngushtë duke vënë të gjitha përgjegjësitë për të zhvilluar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me KBF dhe KMFP si mjet për forcimin e mbikëqyrjes. Mbikëqyrja parlamentare nuk është vetëm deri në komunikimin e ZAP-së me Parlamentin, por është detyrë më komplekse, e cila kryesisht përfshin edhe atë që Parlamenti mban përgjegjëse Qeverinë. Ne besojmë se për forcimin e rolit të ZAP-së Parlamenti duhet të mbajë përgjegjëse Qeverinë. Kjo mund të bëhet duke zhvilluar marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë në mes të ZAP-së dhe KBF/KMFP në njërin anë dhe KBF/KMFP dhe Parlamentit në anën tjetër duke përdorur gjetjet e ZAP-së për të mbajtur qeverinë përgjegjëse.</p>	Pranohet: E adresuar në strategji.
GAP	<p>1. 2.1.4 Kontabiliteti dhe raportimi; Në kuadër të raportit vjetor i cili i dorëzohet Kuvendit, MF duhet t'i fus shpenzimet sipas kodeve ekonomike për të gjitha organizatat buxhetore. Kjo për shkak se organizatat buxhetore qendrore nuk i publikojnë raportet e tyre dhe komisionet e përhershme dhe funksionale parlamentare nuk kanë qasje në shumicën e këtyre raporteve. Në raportet financiare tre-mujore dhe vjetore, MF gjithashtu duhet të përfshijë shpenzimet e ndara në kategori ekonomike për departamentet brenda organizatave buxhetore dhe numrin aktual të të punësuarve</p>	Pranohet: Thesari do publikoj të dhënat konform kërkesave të LMFPP-së. Do ketë veprime në funksion të rritjes së transparencës buxhetore me anë të publikimit të serive kohore të të hyrave dhe shpenzimeve për Qeverinë e përgjithshme.
	<p>2. 2.1.5 Auditimi dhe mbikëqyrja: Mbikëqyrja parlamentare në aprovimin e buxhetit. Projektbuxheti i dorëzuar në Kuvendin e Kosovës megjithëse dorëzohet në afatet ligjore, nuk përmban trendet e viteve të kaluara.</p>	Nuk pranohet; Komisioni për buxhet dhe financa si komision funksional në Kuvendin e Kosovës nga data 1 nëntor deri në aprovim të buxhetit e shqyrton, rekomandon për aprovim Kuvendit të Kosovës.

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>3. Paraqitje e ndarjeve buxhetore në bazë të programeve për të paktën dy vitet e kaluara është thelbësore për përmirësimin e mbikëqyrjes së ndarjeve buxhetore nga komisionet e përhershme dhe funksionale për organizatat buxhetore të cilat i mbikëqyrin ato</p>	<p>Nuk pranohet, sepse duhet të bëhen ndryshime në sistemet për planifikim të buxhetit.</p>
	<p>4. Gjithashtu sipas "Praktikave më të mira të OECD-së për Buxhet transparent" draft-buxheti duhet t'i dorëzohet Kuvendit së paku tre muaj para përfundimit të vitit fiskal. Për këtë arsye, duhet të amandamentohet neni 22 i Ligji bazik për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në këtë mënyrë: "22.1 Pas miratimit të propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore, Qeveria ia dorëzon këto dokumente Kuvendit jo më vonë se më 30 shtator të atij viti fiskal".</p>	<p>Nuk pranohet: PEFA vlerëson se nuk ka probleme në afatet rreth ciklit buxhetore.</p>
	<p>5. 2.2.2 Shtylla 2: Efikasiteti alokues. Ndarja e buxhetit për investime kapitale në komuna. Gjatë hulumtimeve të Institutit GAP dhe organizatave tjera, kemi vërejtur që investimet kapitale të OB-ve qendrore në komuna janë kryer pa studime fizibilitetit (shih shembullin e ndërtimit të shkollës në Komunën e Ferizajt e cila është mbyllur për shkak të mungesës së nxënësve <a href="http://bit.ly/23rjFH1">http://bit.ly/23rjFH1</a>). Përveç kësaj, të gjeturat e Institutit GAP sugjerojnë se këto investime kapitale mund të jenë të ndikuara politikisht (shih infografikën e Institutit GAP-it <a href="http://bit.ly/1XZTF3Q">http://bit.ly/1XZTF3Q</a>), duke diskriminuar komuna të caktuara. Institutit GAP propozon që me ligj të parashihen këto masa në mënyrë që të rritet efikasiteti i shpenzimeve kapitale të OB-ve qendrore në komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) projekt-propozimet kapitale të ministrive të vihen në diskutim publik me komuna;</li> <li>b) propozim-projektet kapitale të diskutohen në komisionet përkatëse Kuvendit të Kosovës të cilat mbikëqyrin ministrinë;</li> <li>c) kost-benefit analiza e të gjitha projekt-propozimeve të ministrive dhe komunave të bëhen publike në faqen e internetit të ministrive</li> </ul>	<p>Pranohet: kjo çështje është adresuar me aktivitetet në kuadër të Prioritetit 6.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

përkatëse	
<p>6. Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të të hyrave 1.5. Instituti GAP e përkrah rritjen e numrit të stafit dhe trajnimeve për njësinë e makro-ekonomisë. Megjithatë duke qenë se në të kaluarën kemi parë raste kur parashikimi i të hyrave është rritur në mënyrë të dukshme në vite zgjedhore, besojmë thellë se problemi i saktësisë së të hyrave nuk është vetëm i natyrës profesionale, por edhe politike. Opsioni paraqitur në këtë strategji i cili pretendon se raportimi i drejtpërdrejtë i njësisë së makroekonomisë tek Ministri i Financave e zgjedh këtë problem, nuk ofron asnjë garanci në pavarësisë së kësaj njësie.</p> <p>Instituti GAP beson se ka disa opsione të cilat mund të sigurojnë pavarësinë e një Këshilli të Pavarur Fiskal:</p> <p><b>a)</b> Trajnimi i anëtarëve të rinj të njësisë për analiza buxhetore në kuadër të Kuvendit të Kosovës që të luajnë rolin e këtij këshilli;</p> <p><b>b)</b> Donatorët dhe ambasadat e pranishme në Kosovë, do të ishin më se të gatshëm që të financojnë trajnimin e anëtarëve të disa think-tanks në Kosovë, të cilët mund të luajnë rolin Këshillit të pavarur Fiskal i cili ka rëndësi tejet të madhe në politikë bërje</p>	<p>Pranohet: çështja në fjalë është adresuar në Prioritetin 1.</p>
<p>7. Prioriteti 5: Besueshmëria e buxhetit vjetor: Buxhetimi i bazuar në programe. Kosova është vonë në zbatimin e buxhetit programor. Përveç MF-së, Qeveria e Kosovës duhet të fillojë pilot-projektin për buxhetim të bazuar në programe edhe me të paktën një komunë dhe institucion të pavarur.</p>	<p>Pranohet: Çështja e adresuar përmes aktivitetit të ri në Prioritetin 5.</p>
<p>8. Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital. Sipas strategjisë "Ndikimi politikë është një ndër faktorët që ndikon negativisht në planifikim të projekteve kapitale, sidomos pas aprovimit të buxhetit nga Qeveria, në komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, futen projektet me vlera më të vogla monetare se sa realisht ato kushtojnë". Deputet e Komisioneve duhet të informohen në baza tre-mujore lidhur me progresin fizik dhe të pagesave lidhur me projektet</p>	<p>Pranohet: Komenti të shqyrtoj mundësinë e raportimit për investimet kapitale me vlerë më të lartë.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>kapitale të institucioneve përkatëse të cilat i mbikëqyrin. Kjo përveç se rrit llogaridhënien, rrit edhe përfshirjen dhe vetëdijen e deputetëve lidhur me propozimin e projekteve gjatë hartimit të buxhetit në vitin e ardhshëm. Gjithashtu në raportin tre-mujorë dhe vjetor të Ministrisë së Financave duhet të përfshihet progresi i secilit projekt kapital gjatë vitit</p>	
	<p>9. Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm: Zhvillimi i mëtejme i praktikës së ZAP për auditimin e performancës: ZAP duhet të obligohet të kryej auditime të performancës për të gjitha organizatat buxhetore, njëjtë sikurse është edhe auditimi i rregullsisë</p>	<p>Nuk pranohet: Propozimi tashmë pjesë e punës së ZAP dhe e aktiviteteve në Prioritetin 9.</p>
	<p>10. Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm: Komunikimi me Kuvendin: Në bazë të Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën 2015, Kuvendi nuk ka kapacitet e duhura për mbikëqyrjen e punës së qeverisë. Të njëjtën gjë e kemi konstatuar edhe gjatë përvojës tonë me komisionet e Kuvendit të Kosovës. Prandaj në kuadër të kësaj mase, duhet të planifikohet edhe rritja dhe trajnimi i stafit mbështetës në Kuvend</p>	<p>Nuk pranohet: Kjo është jashtë mandatit të grupit punues për MFP. Komisioni përkatës përkrahët nga GIZ për ngritjen e kapaciteteve.</p>
	<p>11. Prioriteti 11: Transparenca e informative për buxhetin. Megjithëse në draft-strategji konstatohet se transparenca buxhetore është në gjendje të mirë, këtë nuk e konstaton Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën. Rritja e transparencës ndaj publikut sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve, do të rritë në mënyrë thelbësore efikasitetin në shpenzimin e parasë publike dhe cilësinë e analizave që ofrohen nga studiuesit brenda dhe jashtë institucioneve. Më poshtë kemi renditur një numër të dokumenteve të cilat MF duhet që sa më shpejtë të fillojë t'i publikojë.</p> <p>a) Të gjitha të dhënat e publikuara nga organizatat buxhetore, Dogana dhe ATK duhet të jenë në formatin "Excel";</p> <p>b) ATK të publikojë në baza mujore të hyrat vendore nga TVSH në bazë të produkteve; numri i të punësuarve për sektorë; qarkullimi i deklaruar për sektorë në baza tre-mujorë;</p>	<p>Pranohet: Do të bëhet publikimi i të dhënave në formë të serive kohore mujore për të hyrat dhe shpenzimet e Qeverisë së përgjithshëm.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>c) Dogana e Kosovës të publikojë në baza mujore databazat për import dhe eksport më të gjitha detajet sa i përket: sasisë, vlerës, të hyrat e ndara në bazë të taksave, vendi i importit/ eksportit, dita e importit, kodit doganorë, përshkrimi i produkteve etj;</p> <p>d) Të gjitha OB të publikojnë "Kartelat Analitike të Kontos";</p> <p>e) MF të krijojë portalin qendror ku publikohen të gjitha këto të dhëna.</p>	
	<p>12. Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFB: Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën 2015, përveç mungesës së stafit ka edhe mungesë të profesionalizmit në administratë publike, dhe kjo si pasojë e ndërhyrjes politike dhe mungesës së trajnimeve. Mungesa e trajnimeve profesionale vie si pasojë e mungesës së mjeteve financiare dhe objektit të përshtatshëm për Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Në projekt-buxhetin e vitit 2016, është planifikuar një rritje prej 27 mijë euro (16%) në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe shërbimeve komunale, por numri i të punësuarve në IKAP ka mbetur i njëjtë. Në rast se zgjidhet opsioni i dytë atëherë duhet të parashikohet ndarja e buxhetit për IKAP.</p>	<p>Nuk pranohet: Komenti është i adresuar tashmë në prioritetin 12. Analiza e kosto benefitit do të rekomandojë opsionin, dhe si pasojë veprimet që do të ndermirren në këtë fushë.</p>
SCAAK	<p>Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm Në pikën "Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm" tek aktivitetet e propozuara, pika 8.3 të riformulohet si në vijim Themelimi i programit vendor për certifikimin e auditorëve të brendshëm dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe praktikave të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IIA). Republika e Kosovës do të duhej konsideruar që trajnimi dhe certifikimi i auditorëve të brendshëm të ofrohet nga një institucion profesional i pavarur i cili ofron trajnime kompatible me ato të Instituteve Ndërkombëtare. Një certifikim i tillë i pavarur, jashtë Institucioneve Publike, ndihmon në aspektin e ngritjes së performancës profesionale të auditorëve të brendshëm në institucionet shtetërore dhe publike, qeveria punëson staf të përgatitur profesionalisht, mirëmbajtja</p>	<p>Nuk pranohet: Është konsideruar ky opsion dhe është vlerësuar se programi i MF plotëson kërkesat.</p>

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

	<p>dhe azhurnimi i programit edukativ me zhvillimet globale nuk do të jetë barrë e buxhetit të konsoliduar por e Institucionit të pavarur, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së trajnimit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.</p>	
	<p>Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB Në pikën “Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB” tek aktivitetet e propozuara, pas opsionit të dytë të shtohet opsioni i tretë si në vijim: Trendet e praktikave më të mira globale kanë rezultuar me vendimin e qeverive për trajnimin dhe certifikimin e shërbyesve civil nga Institucionet profesionale të akredituara dhe të pavarura. Një certifikim i tillë i pavarur, jashtë Institucioneve Publike, ka dhënë rezultate të mëdha si në aspektin e ngritjes së performancës profesionale të shërbyesve civil por gjithashtu ka ngritur edhe kredibilitetin e Institucioneve Publike në veçanti me një kosto më të volitshme për buxhetet shtetërore. Kjo për faktin se qeveria punëson staf të përgatitur profesionalisht, mirëmbajtja dhe azhurnimi i programit edukativ me zhvillimet globale nuk do të jetë barrë e buxhetit të konsoliduar por e Institucionit të pavarur, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së trajnimit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.</p>	Pranohet: është adresuar në Prioritetin 12.
	<p>Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB Në pikën “Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB” tek aktivitetet e propozuara, në pikën 12.2 pas fjalës <i>vendimi i duhur</i> të shtohet fjalia si në vijim: si dhe opsionit 3 (organizimi i trajnimeve dhe certifikimeve të shërbyesve civil nga Institucionet profesionale të akredituara dhe të pavarura. Një certifikim i tillë i pavarur, jashtë Institucioneve Publike, ka dhënë rezultate të mëdha si në aspektin e ngritjes së performancës profesionale të shërbyesve civil por gjithashtu ka ngritur edhe kredibilitetin e Institucioneve Publike në veçanti me një kosto më të volitshme për buxhetet shtetërore. Kjo për faktin se qeveria punëson staf të përgatitur profesionalisht, mirëmbajtja dhe azhurnimi i programit edukativ me</p>	Pranohet: është adresuar në Prioritetin 12.

## Kontributet e Ekipit përgjegjës në komentet e pranuar me shkrim gjatë diskutimit publik të Strategjisë për MFP

---

	zhvillimet globale nuk do të jetë barrë e buxhetit të konsoliduar por e Institucionit të pavarur, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së trajnimit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional).	
	Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB Në pikën “Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve MFB” tek aktivitetet e propozuara, pika 12.3 të riformulohet si në vijim Zbatimi i opsionit më të përshtatshëm pas analizës kosto/benefit.	Pranohet: është adresuar në Prioritetin 12.